Wilson Center | Digital Archive
International History Declassified
digitalarchive.wilsoncenter.org

# September 21, 1968
# Telegram from Haxhi Lleshi to Gamal Abdel Nasser

## Citation:

"Telegram from Haxhi Lleshi to Gamal Abdel Nasser", September 21, 1968, Wilson Center Digital Archive, AMPJSh, V. 1968 D.154
https://wilson-center-digital-archive.dvincitest.com/document/110541

## Summary:

This document is a telegram from the Chairman of the Presidium of the People's Council of the People's Republic of Albania, Haxhi Lleshi, to the President of the United Arab Republic (UAR) Gamal Abdel Nasser. Lleshi declares in the letter that the Albanian government sees the situation in the Mediterranean as insecure. The factors that contribute to this state are the hegemony and forceful policies of the United States and the Soviet Union. He adds that both countries deployed their fleets in the Mediterranean. According to various sources, the Albanian government knows that the belligerent Soviet fleet is deployed in various sea bases in the UAR, a "freedom-loving" country and a friend of Albania. The Albanian people are ready to defend their sovereignty and, especially, their coastline from any aggression. Albania supported the struggle of the Arab people against the Israeli attacks of June 5, 1967. Lleshi expresses confidence that the government of the UAR will not allow the use of its ports as bases for aggressive actions against the People's Republic of Albania.

## Original Language:

Albanian

## Contents:

Original Scan

Wilson Center Digital Archive Original Scan

PJ ARKIVI
Viti:
Dosja:
I DEKLASIFIKUAR

47

Tirane, me 21 shtator 1968

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja: Fleta:

I nderuari Zoti President,

I udhehequr nga ndjenjat e larta te miqesise se lashte vellazerore qe lidhin popullin shqiptar me popullin e Republikes Arabe te Bashkuar dhe duke patur parasysh marredheniet miqesore dhe te bashkepunimit te sinqerte qe egzistojne midis dy vendeve, e konsideroj te nevojeshme t'ju çfaq Juve, Zoti President, dhe Qeverise suaj mendimin e Qeverise shqiptare dhe timin personal ne lidhje me gjendjen e pasigurise qe eshte krijuar sot ne pellgun e Mesdheut.

Sipas pikpamjes sone gjendja e ndere dhe e pasigurise per popujt liridashes te ketij rajoni buron para segjithash nga politika e forces dhe e hegjemonise boterore qe ndjekin Shtetet e Bashkuara te Amerikes dhe Bashkimi Sovjetik dhe nga bashkepunimi i ketyre dy fuqive per venjen ne jete te kesaj politike. Nje politike e tille, persa i perket rajonit ne fjale, konfirmohet midis te tjerave edhe me dislokimin e flotave te tyre te luftes ne detin Mesdhe dhe me qendrime e veprime te tilla nga ana e tyre qe kane shpure deri ne agresione te armatosura te paprovokuara, siç ka qene agresioni i armatosur i Izraelit kunder Republikes Arabe te Bashkuar dhe vendeve te tjera vellezer arabe ne qershorin e vitit te kaluar.

Ne keto kushte, populli shqiptar dhe qeveria e tij, roje vigjilente te Atdheut te tyre bregdetar ne Mesdhe, nuk mund te mos konsiderojne me vemendje lajmet dhe te dhenat e

SHKELQESISE SE TIJ
ZOTIT GAMAL ABDEL NASER
PRESIDENT I REPUBLIKES ARABE TE BASHKUAR

K A I R O

Wilson Center Digital Archive Original Scan

MPJ ARKIV
Viti
Dosja
I DEKLASIFIKUAR

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja
Fleta:



ndryshme sipas te cilave rezulton se flota agresive e luftes e Bashkimit Sovjetik ne Mesdhe mbeshtetet ne bazat ushtarako-detare te Republikes Arabe te Bashkuar, vend liridashes dhe mik i Republikes Popullore te Shqiperise.

Sikunder dihet Qeveria shqiptare e ka bere te ditur ne shume raste se prej disa vjetesh udheheqja e Bashkimit Sovjetik ndjek nje politike rrenjesisht armiqesore karshi Republikes Popullore te Shqiperise. Ne fakt Qeveria sovjetike eshte perpjekur te nderhyje brutalisht ne punet e brendeshme te Shqiperise duke perdorur forcat me te ulta - nga shantazhet, presionet politike, bllokadat ekonomike e deri tek organizimi i kompllioteve se bashku me imperialistet amerikane dhe flloten e tyre te VI-te ne Mesdhe kunder lirise dhe pavaresise te popullit shqiptar.

Nuk eshte veshtire te kuptohet ne keto rethana se flota sovjetike ne Mesdhe perben nje nga mjetet kryesore ne duart e Qeverise sovjetike per zbatimin e qellimeve dhe planeve te saj agresive kunder Republikes Popullore te Shqiperise.

Duke marre parasysh kete politike aventuriere te Qeverise sovjetike kundrejt Shqiperise, ne, te udhehequr nga ndjenja thellesisht miqesore, jemi te bindur se Ju, Zoti President, populli vella dhe Qeveria e Republikes Arabe te Bashkuar nuk do te lejojne kurre qe territori i Republikes Arabe te Bashkuar te perdoret si baze sulmi kunder Republikes Popullore te Shqiperise.

Ne jemi te bindur se Ju dhe Qeveria e Republikes Arabe te Bashkuar do te çmojne si duhet gjendjen e krijuar dhe interesat e larta te popullit shqiptar qe na shtyjne neve t'Ju drejtohemi ne menyre miqesore per kete çeshtje. Ne kemi besim te plote se Ju, Zoti President, do te merrni masat e duhura per te evituar krijimin e situatave te padeshernara dhe krejt te huaja per politiken paqesore te Republikes Arabe te Bashkuar si dhe

./..

Wilson Center Digital Archive Original Scan

MPJ ARKIVI
Viti
Dosja

DEKLASIFIKUAR



MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja: Fleta:

per ndjenjat tuaja miqesore dhe te popullit te vendit tuaj ndaj popullit shqiptar dhe Republikes Popullore te Shqiperise.

Nga ana e jone me ju sigurojme Juve, Zoti President, popullin vella dhe Qeverine e Republikes Arabe te Bashkuar, dhe kjo kemi bindje do t'ju gezoje, se populli shqiptar eshte i teri ne kembe dhe i gatshem per te mbrojtur me vendosmeri te patundur kufijte e shenjta te Atdheut te vet dhe me veçanti bregdeti dhe portet e Republikes Popullore te Shqiperise jane keshtjella te pampeshtura nga çdo armik, qofte nga flliota agresive e NATO-s qofte nga flliota agresive sovjetike.

Populli shqiptar dhe populli i Republikes Arabe te Bashkuar jane te lidhur me nje miqesi vellazerore tradicionale te farketuar ne luftrat e perbashketa per lirine dhe pavaresine kombetare. Populli shqiptar ka çmuar kurdohere larte, ka pershendetur dhe perkrahur energjikisht luften e popullit vella te Republikes Arabe te Bashkuar dhe gjithe popujve vellezer arabe kunder imperialisteve dhe kolonialisteve. I gjithe populli shqiptar, Qeveria e tij dhe perfaqesuesit e Shqiperise ne Organizaten e Kombeve te Bashkuara e kudo gjetke kane perkrahur me force kauzen e drejte te Republikes Arabe te Bashkuar dhe vendeve e popujve te tjere arabe kunder imperializmit dhe sionizmit. Ne kemi denuar vendosmerisht dhe me force agresionin piratesk imperialisto-izraelit te 5 qershorit 1967 kunder Republikes Arabe te Bashkuar dhe vendeve te tjere arabe, kemi mbeshtetur plotesisht kerkesat tuaja legjitime dhe jemi solidarizuar me gjithe zemer me luften e drejte te popujve arabe per çlirimin e territoreve te tyre te pushtuara nga fashistet izraelite. Ne jemi te bindur se lufta e drejte e popujve vellezer arabe do te triumfoje me siguri dhe agresoret izraelite e padronet e tyre imperialiste do te shporen nje here e pergjithmone nga tokat arabe. Ne kete lufte te shenjte, populli shqiptar do te jete kurdohere per krah popujve vellezer arabe.

Ne shprehim bindjen se miqesia vellazerore dhe bashkepunimi i sinqerte midis dy popujve dhe dy vendeve tona jo vetem nuk

./.

Wilson Center Digital Archive Original Scan

Viti
Dosja
I DEKLASIFIKUAR

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja: Fleta:



do te mund te prekem nga armiqte e perbashket por do te forcohen kurdohere ne interesin e tyre, ne interes te lirise dhe paqes ne bote.

Pranoni ju lutem, Zoti President, shprehjen e ndjenjave te miqesise se sinqerte dhe te konsiderates sime te larte.

PRESIDENTI I PRESIDIUMIT TE KUVENDIT POPULLOR
TE REPUBLIKES POPULLORE TE SHQIPERISE

( HAXHI LLESHI )